



INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME
PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS
PROGRAM SVEOBUHVATNOG RAZVOJA

RAPORTI I VLERËSIMIT BAZË PËRMBLEDHJE Tetor, 2017

Program i implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

PAX

CBM
Community Building Mitrovica

dhe financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**





INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS PROGRAM SVEOBUH VATNOG RAZVOJA

• Hyrje

Programi *Nxitja e Zhvillimit Gjithëpërfshirës dhe Qeverisjes së Mirë në Veri të Kosovës* (Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës) ka për qëllim të ofrojë një pako gjithëpërfshirëse të mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve komunale për menaxhim dhe planifikim strategjik, fuqizimin e kontratës sociale ndërmjet autoriteteve lokale dhe zgjedhësve duke ngritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e pushtetit lokal, si dhe përmirësimin e koordinimit dhe ofrimit të shërbimeve në kuadër të bashkëpunimit ndër komunal dhe qeverisjes në shumë

nivele. Programi është zhvilluar me kërkesë të Qeverisë së Kosovës dhe është bashkë-financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Programi është duke u zbatuar së bashku nga UN-Habitat, PAX dhe Community Building Mitrovica, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), si dhe autoritetet lokale të komunave partnere të programit: Leposaviq, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan, si dhe Skenderaj dhe Vushtrri.

• Vlerësimi gjithëpërfshirës bazë

Gjatë fazës fillestare të programit, Shtator 2016 – Gusht 2017, është bërë vlerësimi gjithëpërfshirës bazë i gjendjes së qeverisjes lokale. Vlerësimi ka për qëllim të kuptuarit më të thellë të gjendjes aktuale të qeverisjes lokale në komunat veriore, vlerësimin e kapaciteteve në sektorë të ndryshëm dhe përcaktimin e fushëveprimit të mbështetjes që duhet

të ofrohet në fazën kryesore të zbatimit të programit. Për më tepër, vlerësimi i mundëson partnerëve të programit që të planifikojnë dhe përmirësojnë bazën, caqet dhe treguesit dhe do të shërbejë si mjet për monitorim të brendshëm për matjen e progresit me kalimin e kohës.

Vlerësimi bazë është i përbërë nga disa pjesë dhe vlerëson:



PUSHTETIN LOKAL

Kapacitetet dhe praktikatat komunale në ofrimin e shërbimeve komunale dhe në aspektin e planifikimit strategjik hapësinor për ofrimin e bazës për një planifikim dhe menaxhim të përmirësuar të qytetit.



SHOQËRINË CIVILE

Gjendjen e Organizatave të Shoqërisë Civile sa i përket fushave të veprimit, kapacitetet aktuale, kapacitetet dhe praktikatat e nevojshme, duke ofruar një sërë rekomandimesh për fuqizimin e ndikimit që ato mund të kenë në qeverisjen lokale.



PERCEPTIMIN E PUBLIKUT

Te kuptuarit/perceptimi i publikut nëpërmjet fokus grupeve dhe opinionet e tyre mbi shërbimet publike.



ANALIZËN GJINORE

Përbërja gjinore, theksimin e hierarkisë së pushtetit, ndarjen e punës dhe aspektet sociale e kulturore që mund të kenë ndikim në zbatimin e programit.

VLERËSIMI BAZË KOMUNAL

Vlerësimi bazë u realizua nga muaji Dhjetor 2016 deri në muajin Shkurt 2017 në shtatë komuna partnere të programit: Leposaviq, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan, si dhe Skenderaj dhe Vushtrri. Metodatat për mbledhjen e të dhënave nuk janë të kufizuara por përfshijnë: anketat vetë-vlerësuese komunale, fokus grupet komunale, hulumtime të dokumenteve, anketat e inventarizimit të shkathtësive të stafit dhe SWOT analizën e shpejtë (përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet).

Vlerësimi komunal bëhet kundrejt kornizës ekzistuese ligjore të Kosovës mbi funksionet e planifikimit dhe ofrimin e shërbimeve në nivel komunal. Sipas legjislacionit të Kosovës, pushteti lokal është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor strategjik dhe operativ, si dhe menaxhimin e proceseve dhe procedurave administrative të ndërlidhura me to. Vlerësimi shqyrton kapacitetet dhe praktikën e komunave për planifikim dhe menaxhim. Analiza do të ofrojë bazën për zhvillim organizativ, profesional dhe të komuniteteve për planifikim dhe menaxhim të përmirësuar të qytetit,

si dhe ofrim të përbashkët të shërbimeve në mënyrë të koordinuar dhe efikase në kuadër të perspektivës për integrim.

Të anketuarit janë nëpunësit civil në administratat komunale, në veçanti udhëheqësit dhe zyrtarët e drejtorive dhe sektorëve përkatës, si dhe stafi i Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) nga sistemet administrative të Kosovës dhe ato të serbeve në veri.

	VVK	AISHS	FGK
♂	41	42	45
♀	15	30	25
Totali	56	72	70

Numri dhe gjinia e zyrtarëve komunal të anketuar gjatë vlerësimit Assessment¹

1 VVK: Vetë-vlerësimi komunal
AISHS: Anketa për Inventarizimin e Shkathtësive të Stafit
FGK: Fokus Grupet Komunale

• Planifikimi i produkteve dhe proceseve: ku qëndrojnë komunat veriore?

Komunat Vushtrri, Mitrovicë e Jugut dhe Skenderaj kanë dokumente të vlefshme të planifikimit hapësinor apo aktualisht janë duke ri-hartuar planet e tyre në mënyrë që t'i plotësojnë kërkesat e reja të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-174 mbi Planifikimin Hapësinor i vitit 2013. Në ndërkohë, komunat e Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan kanë dokumente të vjetruara të planifikimit hapësinor, të

hartuara në kuadër të kornizave të Jugosllavisë/Serbisë dhe Malit të Zi/Serbisë (kryesisht nga vitet e 90-ta). Në rastin e Mitrovicës së Veriut, Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Plani Zhvillimor Urban (PZHU) ishin hartuar para krijimit të dy komunave të reja (2013), Mitrovica e Jugut dhe Mitrovica e Veriut.


DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

NË FUQI

Skenderaj: PZHK (2017)
Vushtrri: PZHK (2017)
Mitrovica S: PZHK/PZHU (2008)
Mitrovica N: PZHK/PZHU (2010)

SKADUAR/REVOKUAR

Zveçan: PRRD (2007)
PDU (1997)
PGJU (1996)
Zubin Potok: PGJU (2000)
PDU/PRRD (1992)
PHK (1991)
Leposaviq: PGJU (1994)



DOKUMENTET (MULTI)-SEKTORALE TË PLANIFIKIMIT

STRATEGJIA APO PROGRAMI I BANIMIT

Vushtrri (2015-18) / Mitrovica S (2016-19)

MJEDISI (PLVM)

Leposaviq (2017-20) / Vushtrri (2014) /
Zubin Potok (2017-20) / Zveçan (2015-20)

MENAXHIMI I RESURSEVE DHE MBETURINAVE

Vushtrri: PKEE (2014-20) / PMM (2015)
Zubin Potok: PKEE (2015-18)
Skenderaj: PMM (2016-20)

SHËRBIMET PUBLIKE

Vushtrri: Plani për përmirësimin e sistemit të mobilitetit (2017-19)


STRATEGJITË PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Leposaviq: Turizëm PSZ (2017-22)
Skenderaj (2013-17) / Vushtrri (2013-18) / Zveçan (2014-16)

Në Vushtrri dhe Skenderaj, shumica e dokumenteve sektoriale strategjike/operacionale ishin hartuar nga vetë këto komuna me mbështetjen e partnerëve komunal/donatorëve. Në katër komunat veriore, formulimi i dokumenteve jo-statusore afatshkurta ishin iniciuar dhe mbështetur nga administrata e pushtetit qendror dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në Kosovë. Në fund të këtyre proceseve hartuese, dhe përkundër mungesës evidente të pronësisë nga administratat përkatëse lokale, shumica e këtyre dokumenteve ishin miratuar nga kuvendet komunale, por zbatimi mbetet i diskutueshëm.

Shkalla e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit ndryshon shumë prej një komune në tjetrën. Këto procese zakonisht nuk janë të dokumentuara mirë.

- Në komunat Mitrovicë e Jugut, Vushtrri dhe Skenderaj ishin krijuar grupet punuese tematike për hartimin e dokumenteve të planifikimit sektorial, duke i përdorur mjetet e tilla si takimet bilaterale dhe takime e përbashkëta me ekspertët, drejtorët, qytetarët apo fshatarët.
- Në komunën e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit, të gjitha proceset e planifikimit hapësinor strategjik dhe operacional ishin realizuar me të ashtuquajturat procese pjesëmarrëse “të vjetra”. Mjetet dhe teknikat ishin të përbëra nga prezantimet publike dhe lokale me komunitetet, si dhe debate dhe periudhat e shqyrtimit.



• Të dhënat dhe informacionet: mbledhja, shkëmbimi, sigurimi dhe ruajtja

Të gjitha komunat kanë përvojë të kufizuar në realizimin e hulumtimeve cilësore dhe sasiore të të dhënave dhe informacioneve në mbështetje të formulimit të dokumenteve të planifikimit strategjik dhe operacional. Të dhënat dhe informacionet më së shumti vijnë nga pushteti qendror (qoftë nga sistemi administrativ i Kosovës apo sistemi administrativ i Serbisë për katër komunat veriore) apo janë të shpërndara në drejtori të ndryshme komunale. Asnjë regjistrim nuk është ndërmarrë në veri që nga viti 1991 dhe të dhënat akoma janë të paqëndrueshme në këtë kontekst. Asnjë nga komunat – përveç Mitrovicës së Veriut – nuk kanë drejtori të dedikuar për sistemet e informacionit dhe menaxhimin e të dhënave.

REKOMANDIMET

Të fuqizohen kapacitetet komunale për hartim, zbatim, monitorim e vlerësim dhe përmirësimi i pronësisë komunale, duke:

- ri-fuqizuar funksionet koordinuese dhe nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së drejtorive përkatëse komunale në proceset e hartimit,
- ndarë fonde/buxhet për formulimin e dokumenteve dhe menaxhimin e proceseve,
- ndërgjegjësuar kuvendin komunal dhe partitë politike mbi nevojat për planifikim hapësinor.



Reforma legislative e planifikimit hapësinor– nën udhëheqjen e administratës së pushtetit lokal duhet të sajohen një sërë instrumentesh të decentralizuara dhe pjesëmarrëse të planifikimit– dhe mbështetja e ndërlidhur e Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës do të mund/duhet të shfrytëzohet si mundësi për fuqizimin e kapaciteteve komunale për hartim, zbatim, monitorim dhe vlerësim.



Proceset e gjinore të ndjeshme, në planifikim, menaxhim dhe zhvillim duhet të prezantohen dhe të zbatohen në vazhdimësi.

► *A keni genë ndonjëherë të përfshirë në ndonjë aktivitet që lidhet me proceset e planifikimit?*

Burimi: Anketa për inventarizimin e shkathtësive të stafit, UN-Habitat, shkurt 2017

REKOMANDIMET

Të përmirësohet sistemi dhe protokollet për menaxhimin e të dhënave dhe informacioneve,

SPAK

duke përdorur mbështetjen qendrore në dispozicion në harmoni me Aplikacionin e Planifikimit Hapësinor në Kosovë për krijimin e bazës të dhënave (databazës) së integruar komunale.



Duhet të mbështetet prezantimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në proceset e planifikimit strategjik.

• Harmonizimi me kornizën legislative

Vushtrri, Skenderaj dhe Mitrovicë e Jugut

Zyrtarët komunal janë në përgjithësi të familjarizuar me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, legjislacionin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), Ligjin mbi Ndërtimin, Ligjin mbi Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje dhe udhëzimet e ndërlidhura administrative.

Është konstatuar se ajo që nevojitet është udhëzimi praktik dhe përdorimin e instrumenteve të reja të sjella nga reforma në planifikim, për shembull për procesin e hartimit të Hartës Zonale Komunale.

Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut

Korniza legislative për planifikim, zhvillim dhe menaxhim hapësinor/sectorial në Kosovë duhet të zbatohen që nga zero; dhe vlerësimi tregon se ekziston gatishmëria për ta bërë këtë.

• Koordinimi dhe bashkëpunimi institucional

Vushtrri, Skenderaj dhe Mitrovicë e Jugut

Ekziston një lloj bashkëpunimi ndërmjet këtyre komunave, por zakonisht është ad-hoc dhe pa marrëveshje formale. Megjithatë, Vushtrria dhe Skenderaj janë të interesuar në formimin e ekipeve së bashku me komunat fqinje për investime të përbashkëta kapitale dhe Mitrovica e Jugut është njëjtë e interesuar për formimin e ekipeve me komunat jugore dhe veriore, varësisht nga lloji i investimit kapital/ofrimi i shërbimit.

Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut

Katër komunat veriore janë të interesuara dhe të zotuar për formimin e ekipeve me komunat fqinje në "rajon", në veçanti me komunat veriore me shumicë serbe, për hartimin dhe zbatimin e përbashkët të projekteve kapitale.

Ekziston nevoja për linja më të mira të komunikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit mes

- komunave veriore me shumicë shqiptare dhe serbe
- administratës qendror –Kosovë- dhe komunave veriore me shumicë serbe
- te institucioneve dhe ofruesit qendror dhe rajonal te shërbimeve ose shërbimeve tjera komunale.

REKOMANDIMET

- Do të mund të prezantoheshin mekanizma të mëtejshëm në nivel qendror për mbështetje dhe monitorim efikas të zbatimit të kornizës ligjore të planifikimit hapësinor, duke siguruar kështu përputhshmëri ndërmjet planeve dhe efekteve të vazhdueshme të veprimeve që janë duke u ndërmarrë në shkallë të ndryshme.
- Aktivitetet për trajnim dhe ngritje/fuqizim të kapaciteteve duhet të përdoren në mbështetje të zbatimit të kornizave të zhvillimit të planifikimit hapësinor dhe menaxhimit mjedisor, si dhe për menaxhimin e proceseve pjesëmarrëse gjithëpërfshirëse menaxhuese (programi i trajnimit i IKAP).
- Zgjedhjet e ardhshme (Tetor 2017) mund të jenë momenti i duhur për sensibilizimin e udhëheqësve dhe menaxhmentit të ri komunal në lidhje me kornizat relevante legislative dhe mjetet korresponduese për vendimmarrësit.

REKOMANDIMET

- Dialogu i politikave me administratën e pushtetit qendror – Kosovë, ministritë dhe agjencitë e specializuara duhet të vazhdojë dhe të thellohet.
- Në komunat me shumicë serbe, ekziston nevoja për ri-fuqizimin e besimit të komunitetit lokal në administratën e pushtetit lokal, OJQ-të lokale dhe në administratën e pushtetit qendror – Kosovë/Serbi.
- Resurset njerëzore dhe financiare duhet të grupohen për të inkurajuar iniciativën për bashkëpunim me komunat fqinje, si në nivel politik ashtu edhe në atë teknik.



Ndihma për Investime Kapitale që duhet të prezantohet në fazën kryesore të programit dhe duhet të përdorë kriteret për kualifikim për mbështetjen e mëtejshme të bashkëpunimit horizontal dhe vertikal.

• **Partneriteti me shoqërinë civile**

Të gjitha komunat kanë realizuar procese/aktivitete të caktuara të planifikimit, zhvillimit dhe menaxhimit me angazhimin e komunitetit lokal, por ato kanë kapacitete të kufizuara për menaxhimin e këtyre proceseve të planifikimit gjithëpërfshirës dhe prandaj komunikimi nuk ka mekanizma mbështetës. Partneritetet zakonisht krijohen në baza ad-hoc dhe iniciohen nga OJQ-të. Prandaj, të gjitha komunat përballen me nevojën për zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse dhe shoqërisë civile.

Ekziston gatishmëria e komuniteteve/qytetarëve që të informohen, të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në proceset e planifikimit.


• **Resurset njerëzore**

Në Vushtrri, Skenderaj dhe Mitrovicë e Jugut duhet të ngritët vetëdijesimi dhe njohuria sa i përket rolit dhe përdorimit të politikave të integruara sektoriale dhe të planifikimit hapësinor si mjet për zhvillim. Duhet të ngritën edhe kapacitetet teknike.

Në anën tjetër, situata në komunat veriore mbetet komplekse, pasi që administratat e pushtetit lokal operojnë paralelisht, me dy sisteme administrative (të Kosovës dhe Serbisë). Zyrtarë të caktuar punësohen nga të dyja administratat, Kosova dhe Serbia; ndërsa shumica akoma punësohen nga administrata e Serbisë.

Në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, administratat lokale duhet të zhvillohen apo kompletohen sipas sistemit të Kosovës.

Nga transformimi në konsolidimin e mëtejshëm të sistemit të Kosovës në komunat veriore:



kapacitetet e përgjithshme njerëzore që janë relevante për planifikimin hapësinor në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut.

REKOMANDIMET

- Vetëdijesimi dhe njohuritë sa i përket potencialit të shoqërisë civile duhet të ngritët për t'i inkurajuar komunat që (të marrin iniciativën që të) realizojnë procese gjithëpërfshirëse të planifikimit dhe zhvillim pjesëmarrës të politikave dhe vendimmarrje. Kjo duhet/mund të shfrytëzohet si mënyrë për rritjen e nivelit të besimit të tyre në administratën komunale dhe përgjegjshmëri dhe realizim/ofrim të përmirësuar nga administratat lokale.

REKOMANDIMET

Ngritja e vetëdijesimit, njohurive dhe praktikave mbi nevojat për planifikim hapësinor strategjik dhe operacional, legjislaion...

- Nëpërmjet trajnimeve të synuara dhe aktiviteteve për ngritjen/fuqizimin e kapaciteteve të ofruara për të ndihmuar në përballje me reformën e planifikimit dhe mbulimin e boshllëqeve specifike teknike, d.m.th. GIS.
- Gjithashtu asistenca në vendin e punës mund të ndihmojë në përshpejtimin e ofrimit/realizimit komunal gjatë tranzicionit nga ai Serb tek ai Kosovar.

Asistimi në përfundimin e përshkrimeve të punës në drejtoritë e ndërlidhura me planifikim sipas sistemit të Kosovës; lehtësimi i procesit të tranzicionit.

Aktivitetet kryesore të nevojshme ligjore dhe teknike sipas administratave të pushtetit lokal:

TRAJNIMI LIGJOR
<i>Rolet dhe përgjegjësitë institucionale</i>
<i>Proceset dhe procedurat</i>
<i>Monitorimi</i>
<i>Raportimi mbi zbatimin</i>
TRAJNIMI TEKNIK
<i>Planifikimi Hapësinor Strategjik</i>
<i>Planifikimi dhe dizajnimi urban</i>
<i>Mjetet për Menaxhimin e Projektit</i>
<i>Teknologjia për Mbledhjen e të Dhënave (GIS, CAD)</i>

Roli i organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) në zhvillimin gjithëpërfshirës dhe qeverisjen e mirë është vital, pasi që këto mund të shërbejnë si urë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike, mobilizimin dhe artikullimin e nevojave dhe pritjeve të qytetarëve dhe negocimin me zyrtarët mbështetës për të qeverisur në interes të publikut. Nëse përfshihen të gjithë akterët në ciklin e politikave publike, nga planifikimi në zbatim dhe vlerësim, rezultatet e zhvillimit dhe bashkëpunimit do të harmonizohen më mirë me nevojat dhe pritjet e qytetarëve dhe më pak gjasa për përjashtim apo disfavorizim të zgjedhësve specifik në

• Analiza e kontekstit

Në gjithë Kosovën, gjithëpërfshirja e shoqërisë civile në krijimin e infrastrukturës ligjore dhe ndërtimin e institucioneve publike ka qenë një sfidë e vazhdueshme për shkak të mungesës së kapaciteteve në qeveri dhe shoqëri civile. Duke pasur parasysh rëndësinë e saj, shumë donatorë kanë investuar në krijimin e ekspertizës së nevojshme për shoqërinë civile, në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në këto procese. Gjithëpërfshirja e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse garantohet me kornizën relevante ligjore. Përveç kësaj, shumë mekanizma institucional, si këshilla të themeluar në pushtetin qendror dhe lokal, përfshirë pjesëmarrjen e OSHC-ve në hartimin e politikave dhe proceset vendimmarrëse. Në tri vitet e fundit, kontributi i përgjithshëm i shoqërisë civile në politikë-bërje është intensifikuar, kryesisht për shkak të funksionimit të përmirësuar të institucioneve publike. Ekzistojnë më shumë se 8000 OSHC të regjistruara në Kosovë, por vetëm 10-15% raportohen të jenë aktive.

Në shtatë komuna të Rajonit të Mitrovicës, raportohen të jenë 61 OSHC aktive.

PROFILI I PËRGJITHSHËM I OSHC-VE

Organizata relativisht të vogla
Të varura në financim afatshkurtër
Donatorë të vetëm
Karakter mono-etnik

FUSHAT KRYESORE TË INTERESIT

(për më shumë se 50% prej tyre)
Pjesëmarrje e qytetarëve
Monitorimi i transparencës
Bashkëpunimi me komunat

shoqëri. Qëllimi i vlerësimit bazë të shoqërisë civile është pasqyrimi i gjendjes së OSHC-ve në Kosovën veriore dhe në çfarë mase ato mund të përfaqësojnë zërat e qytetarëve dhe të ndikojnë në politika. Vlerëson kontekstin ligjor, kapacitetet organizative të OSHC-ve dhe dialogun dhe bashkëpunimin ekzistues ndërmjet komunave dhe OSHC-ve. Gjithashtu ofron një grup të rekomandimeve mbi fuqizimin e ndikimit të OSHC-ve në lidhje me qeverisjen lokale. Vlerësimi bazë i shoqërisë civile është zbatuar nëpërmjet fokus grupeve me OSHC-të, ku së fundi gjithsej pesë OSHC janë përzgjedhur për vlerësim të hollësishëm.

Disa nga këto OSHC kanë zgjedhës të mirëfilltë publik apo ndërmarrin veprime afatgjata të avokimit dhe fushatave. Kapacitetet administrative, financiare dhe menaxheriale të OSHC-ve rajonale janë të pabarabarta. Në aspektin e dukshmërisë, prania e shoqërisë civile në media është e ulët, përderisa komunikimi dhe mirëkuptimi ndërmjet dy sektorëve është i kufizuar. Ndikimi i OSHC-ve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave është shumë i kufizuar për shkak jo vetëm të mangësive të shoqërisë civile, por gjithashtu sfidave rreth llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe transparencës që karakterizojnë institucionet publike në rajon, si tjetërkund në Kosovë. Një vlerësim² i fundit i sektorit të shoqërisë civile konstatoi se në përgjithësi, është zhvilluar një bazë e mirë për angazhimin e qytetarëve në të gjitha nivelet e qeverisë, por shfrytëzimi i kësaj baze është duke mbetur prapa kuadrin ligjor dhe të politikave. Si e tillë, shoqëria civile në Rajonin e Mitrovicës është e kufizuar në aftësinë e saj për të përfaqësuar zërin e përgjithshëm të qytetarëve në lidhje me shtetin.

Në komunat me shumicë serbe, situata për OSHC-të është edhe më komplekse. Me zgjedhjet e mbajtura në këto komuna në vitin 2013 u krijuan institucionet e reja në harmoni me ligjin e Kosovës. Megjithatë, strukturat paraprake ("paralele") që raportojnë në Beograd nuk ishin shpërbërë, raportet me Prishtinën ende mbesin të tensionuara dhe orientimi i liderëve lokal të zgjedhur rishtazi drejt Beogradit ka dëmtuar besimin publik. Kështu, OSHC-të përballen me sfidën e drejtimit të raporteve të paqarta dhe nganjëherë të ngarkuara ndërmjet autoriteteve komunale që operojnë brenda sistemeve kosovare dhe serbe. Shoqëria civile gjendet përball një presion të veçantë politik të madh kur dëshirojnë të bashkëpunojnë me partnerët nga jugu.

² Raporti për Vlerësimin e Nevojave të Kosovës, Janar 2014: http://www.tacso.org/doc/nar_ko2014april.pdf

• Të gjeturat e vlerësimit

Shumica e OSHC-ve që veprojnë në Rajonin e Mitrovicës nuk kanë përvojë dhe kanë kapacitete të kufizuara organizative; megjithatë, ekzistojnë disa shembuj të mirë të bashkëpunimit dhe ekziston një bazë e mirë për angazhimin e qytetarëve që do të mund të zhvillohej përgjatë zbatimit të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës.

- Në lidhje me kornizën ligjore:

Ekziston një kornizë ligjore që është miratuar nga të gjitha komunat dhe mekanizmat institucional për pjesëmarrje. Kjo kornizë legjislative dhe rregullatore është vlerësuar të jetë e avancuar dhe në harmoni me standardet më të larta dhe praktikatat më të mira të qeverisjes së mirë të BE-së; megjithatë, nuk është zbatuar gjerësisht dhe madje edhe në masë edhe më të vogël në veriun e Kosovës.

- Në lidhje me kapacitetet organizative:

Kapacitetet organizative të OSHC-ve në Kosovë janë përmirësuar gjatë dekadës së fundit, por OSHC-të janë të vetëdijshme për mungesën e përvojës dhe kapacitetet e kufizuara organizative. Vetëm 10% e OSHC-ve në Rajonin e Mitrovicës kanë zhvilluar strategji dhe kanë krijuar struktura të brendshme afatgjate. Megjithatë, disa nga ato më të zhvilluarat kanë filluar të investojnë në fuqizimin e kapaciteteve të tyre organizative. Më shumë se gjysma e organizatave komunikojnë me publikun nëpërmjet ueb-faqes dhe llogarive në Facebook për promovimin e misionit, qëllimeve dhe vizionit të tyre. Financimi mbetet problem.

- Në lidhje me dialogun dhe bashkëpunimin:

Vetëm një numër i vogël i organizatave që veprojnë në këto shtatë komuna bashkëpunojnë me OSHC-të tjera për të rritur fushëveprimin apo zërin e tyre kolektiv. Partneritetet me përfitim të ndërsjellë ndërmjet OSHC-ve nga komunat me shumicë shqiptare dhe ato me shumicë serbe janë të rralla dhe zakonisht të bazuara në projekt.

- Në lidhje me kapacitetet teknike:

Nevoja për ngritjen e kapaciteteve është edhe më e madhe për organizatat që punojnë në komunat me shumicë serbe. Komunat nuk kanë mekanizma adekuat për bashkëpunim; nuk ka Zyre të Shoqërisë Civile në Kosovë dhe Zyrat për Komunikim me Publikun në Kosovë nuk janë operacionalizuar, d.m.th. kanë mungesa në staf dhe resurse. Në disa raste, zyrtari komunal i dedikuar për të rinjtë ngarkohet me përgjegjësi për bashkëpunim me shoqërinë civile (në Vushtrri dhe Skenderaj). Ekzistojnë disa OSHC të nivelit qendror të angazhuar në përpjekjet monitoruese në disa nga shtatë komunat dhe zakonisht hyjnë në partneritet me OSHC-të lokale në mënyrë që të zbatojnë projektet e tyre. Kjo praktikë ka treguar se ekziston nevoja për ekspertizë dhe trajnime të OSHC-ve lokale të gatshme që të angazhohen.

RASTI I EKIPIT MONITORUES PËR RAJONIN E MITROVICËS (EMRM)

[Një nga disa shembujt e partneriteteve kuptimplote bashkëpunuese dhe me karakter ndëretnik]

Është një koalicion joformal i krijuar për të rritur ndikimin e OSHC-ve me fokus në monitorimin e pushtetit lokal dhe promovimin e qeverisjes së mirë. Koalicioni përbëhet nga 21 organizata anëtare që punojnë në Rajonin e Mitrovicës, nga të cilat 8 janë kryesisht organizata Serbe. EMRM ka zhvilluar strategjinë e tij të mbështetur nga CBM.

Mbështetje për EMRM duhet të përmirësojë aftësinë e OSHC-ve në Rajonin e Mitrovicës që të veprojnë në bashkëpunim dhe në këtë mënyrë të rritin ndikimin e tyre në qeverisjen lokale

REKOMANDIMET KRYESORE

- OSHC-të duhet të fuqizojnë kapacitetet e tyre të brendshme menaxhuese (veçanërisht kapacitetet për menaxhim financiar), ekspertizën e tyre teknike në fushat në të cilat fokusohen (veçanërisht planifikimin hapësinor, për ato OSHC të përfshira në zbatim të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës), orientimin e tyre strategjik dhe kapacitetin për të siguruar paraqitjen e tyre dhe për të promovuar komunikimin e ndërsjellë me publikun.
- Në dizajnimin dhe përgatitjen e kurrikulave të trajnimit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave specifike të OSHC-ve, në mënyrë që niveli i trajnimit të përshtatet me kapacitetet e tyre absorbuese.
- Organizatat kanë nevojë për trajnim në fuqizimin e ndërveprimit të tyre me zgjedhësit e tyre që të adresojnë më mirë nevojat e komunitetit dhe të paraqesë shqetësimet e tyre tek autoritetet lokale.
- Bashkëpunimi sektorial ndërmjet komunave dhe OSHC-ve duhet të kodifikohet kurdo që është e mundur dhe të informohet nga praktikatat më të mira nga rajoni dhe Kosova më gjerësisht.
- Komunat duhet të krijojnë stafin dhe të financojnë në mënyrë të duhur mekanizmat për bashkëpunim strategjik me shoqërinë civile, si Zyrat për Qasje të Qytetarëve, dhe të zhvillojnë Plane të Pjesëmarrjes së Qytetarëve e që janë specifike, të matshme dhe reale.
- Komunat duhet të përcaktojnë caqe të matshme për adoptimin e mekanizmave të demokracisë direkte, të tilla si buxhetimi me pjesëmarrje.

Për të plotësuar vlerësimin komunal dhe të shoqërisë civile u mbajtën fokus grupe me qytetarët për të hulumtuar opinionin publik mbi gjendjen e zhvillimit dhe qeverisjes, sidomos sa i përket performancës, transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së administratave komunale. Gjetjet janë të synuara për mbështetjen e rekomandimeve për komunat dhe akterët tjerë në adresimin e sfidave kryesore dhe mundësive për nxitjen e qeverisjes së mirë në veri të Kosovës.

• Në lidhje me performancën komunale

Shërbimet komunale në vijim, si Transporti Publik (Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut), Sport dhe Rekreacion (Zubin Potok), Shërbime Administrative (Mitrovicë e Jugut) dhe Arsim (Leposaviq). Vlen të theksohet se, shumica e të anketuarve pajtohen që ofrimi i shërbimeve administrative ishte i kënaqshëm, duke e radhitur atë si një nga tri shërbimet kryesore me të cilat kanë qenë më të kënaqur.

Në anën tjetër, të anketuarit ishin më së paku të kënaqur me këto shërbime komunale në komunat e tyre përkatëse: ujësjellës (Zveçan), mobilitet i pa-motorizuar (Zubin Potok, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut) dhe Sport dhe Rekreacion (Leposaviq). Banorët e Mitrovicës së Veriut–Mitrovicës së Jugut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut të gjithë e theksuan se “mobiliteti i pa-motorizuar” është një nga shërbimet më pak të kënaqshme komunale. Çështjet të cilat të anketuarit i adresuan ishin: mungesa e trotuareve dhe shtigjeve të biçikleta; keqpërdorimi i trotuareve si hapësira për parkim; problem i qasjes për personat me nevoja te veçanta; dhe mobiliteti i pa-motorizuar i kufizuar.

Tri fokus grupe janë realizuar ndërmjet mesit të muajit shkurt deri në fund të muajit Mars 2017. Në grupin e parë morën pjesë vetëm gratë nga Mitrovica Jugore, përderisa në dy të tjerat morën pjesë edhe gratë edhe burrat. Grupet e mëvonshme ishin gjithashtu të përziera sipas komunave; një me qytetarët e Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit, dhe tjetra me qytetarët nga Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Janë bërë përpjekje për të arritur diversitet në aspektin e sfondit gjinor dhe socio-ekonomik (pensionerëve, të papunëve, studentëve, fermerëve, mësimdhënësve dhe/ose anëtarët dhe aktivistët e organizatave të shoqërisë civile).

Sa i përket pakënaqësive tjera, nuk mund të veçohet vetëm një çështje e vetme. Çështjet në vijim janë ri-përsëritur apo janë theksuar në veçanti nga pjesëmarrësit: I) mirëmbajtja dhe kushtet e qendrave shëndetësore; mungesa e stafit profesional dhe medikamenteve; II) transporti publik ose nuk ekziston ose është në gjendje të keqe, III) mbledhja e mbeturinave të ngurta; IV) mungesa apo gjendja e keqe e pajisjeve për sport dhe rekreacion.

Zveçani duket të ketë probleme specifike, pasi që pjesëmarrësit nga kjo komunë ishin të vetmit që theksuan “ujësjellësin”(cilësi e keqe e ujit, furnizim i dobët) dhe “qendrat sociale” (nuk ka shtëpi për të moshuarit, shërbime të dobëta) si probleme më të konsiderueshme në komunën e tyre. Edhe pse vetëm shërbimi për “mbledhjen e mbeturinave të ngurta” është konsideruar “shumë i pakënaqshëm” nga të anketuarit nga Leposaviqi dhe Mitrovica e Jugut, vlen të theksohet që të gjithë pjesëmarrësit treguan se ka problem me mbeturina, ndotje të lumit dhe deponi joformale në komunitetet e tyre.

Sipas të anketuarve, prioritetet në komunat e tyre duhet të jenë

	ZVEÇAN	ZUBIN POTOK	MITROVICA J.	MITROVICA V.	LEPOSAVIQ
Prioriteti 1	Sport dhe Rekreacion	Arsimi	Arsimi	Arsimi	Social Centers
Prioriteti 2	Qendrat Sociale	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor	Kujdesi shëndetësor
Prioriteti 3	Arsimi	Hapësira publike	Hapësira publike	Hapësira publike	Transporti Publik

• Në lidhje me komunën

Në përgjithësi, pjesëmarrësit duket të jenë përfshirë më së shumti në pjesën e “planifikimit” të procesit të planifikimit, në të gjitha fazat e planifikimit, përveç për “konsultim”. Vendosja apo të vepruarit së bashku, kur është puna për përcaktimin e prioritetit, buxhetit dhe përzgjedhjen e investimeve mbetet i ulët.

Për përmirësimin e transparencës komunale, rekomandohet që qytetarët të rritin nivelin e tyre të përfshirjes në:

- planifikimin e buxhetit, investime, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe drejtimin/orientimin e tyre.
- proceset e planifikimit dhe veçanërisht të përfshihen në fazat më të hershme të procesit të planifikimit.

• Në lidhje me përgjegjshmërinë komunale

Sa i përket përgjigjes së administratës komunale në hulumtim, pjesëmarrësit duhet të vlerësonin atë sipas disa kriterëve (për shembull, kreativitet dhe fleksibilitet). Për Mitrovicën e Jugut, asnjë trend i veçantë nuk mund të vërehet në anketë. Në anën tjetër, shumica e pjesëmarrësve nga Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku dhe Leposaviqi e konsiderojnë edhe në këtë kohë të pa përshtatur dhe

mungesë të përgjegjshmërinë të komunës dhe më pak kreative dhe fleksibël. Në 4 komunat veriore, ekziston mungesa e përgjithshme e përgjegjshmërisë kur bëhet fjalë për mbledhjen e mbeturinave.

- Ekziston nevoja për fokus më të mirë në çështjet mjedisore dhe në zbatimin e ligjit në përgjithësi.

• Në lidhje me llogaridhënien komunale

Duket se ka dakordim të thuhet se, në parim, administrata komunale mbështet/inkurajon kontributin e qytetarëve apo anëtarëve të OSHC-ve në proceset vendimmarrëse.

Shumica e pjesëmarrësve u dakorduan që administrata komunale nuk i ka komunikuar qëllimet dhe objektivat e qarta për zhvillim komunal. Vetëm në Mitrovicën e Jugut mendojnë ndryshe. Problemet kryesore që theksuan të anketuarit ishin pasiviteti dhe mungesa e komunikimit ndërmjet administratave dhe qytetarëve (kanalet e komunikimit nuk janë mjaft të qasshme). Ata të gjithë erdhën në përfundim që: I) qytetarët duhet të organizohen në vend se të veprojnë në mënyrë individuale dhe II) nevojitet asistencë politike dhe financiare nga niveli

qendror.

Për të përmirësuar llogaridhënien, komunat duhet të punojnë në:

- Vetëdijesim dhe mundësi: Komuna duhet të ndërgjegjësoj qytetarët sa i përket të drejtave të tyre dhe të krijojë mundësi për ata që të komunikojnë.
- Disponueshmëria e informacioneve: për debat publik (në gjuhën serbe) dhe veçanërisht të shtypura.
- Raportimi dhe komunikimi i ndërsjellë: komunat duhet t'i raportojnë arritjet e tyre. Gjithashtu duhet të fokusohen në atë se si komunat i integrojnë idetë e qytetarëve në proceset e tyre vendimmarrëse.

• Ku qëndron veriu në raport me Kosovën?

Për të verifikuar besueshmërinë e të gjeturave tona, rezultatet krahasohen me ato nga Anketa Mozaiku i Kosovës 2015 (AMK). Sipas kësaj ankete, Kosovarët janë në përgjithësi të kënaqur me shërbimet e administratës publike, që është në përputhje me të gjeturat tona. Megjithatë, niveli mesatar i kënaqshmërisë me të gjitha shërbimet publike ka rënë pak mes viteve 2012 dhe 2015. Rezultatet nga AMK gjithashtu konfirmojnë disa nga të gjeturat tona sa i përket kënaqshmërisë me efikasitetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë komunale.

Megjithatë, disa të dhëna të gjetura në fokus grupe kanë tendencë të zbulojnë disa specifika në komunat veriore, të cilat i japin nuancë rezultateve kombëtare të Anketës Mozaik. Në të vërtetë, niveli i kënaqshmërisë në Leposaviq, Mitrovicën e Veriut, Zvečan dhe Zubin Potok është shpesh më i ulët se mesatarja kombëtare: veçanërisht sa i përket gjendjes së trotuareve dhe mirëmbajtjes së rrugëve, mbledhjes së mbeturinave të ngurta dhe besimit të përgjithshëm në pushtetin lokal.

ÇËSHTJA E SISTEMIT TË DYFISHTË

Për të kuptuar më mirë rezultatet specifike të gjetura në komunat veriore është mirë të analizohet se si ndikon ekzistenca e sistemeve paralele në perceptimin e publikut dhe përvojat me administratat.

Pjesëmarrësit kanë theksuar vështirësi që të përballen me sistemin e dyfishtë atë të Kosovës dhe atë të Serbisë, veçanërisht sa i përket performancës dhe llogaridhënies. Disa të gjetura nga një tjetër anketë janë paraqitur³:

- NIVELI I BESIMIT
- | | |
|--|--------|
| Qeveria në Beograd | 14,3 % |
| Institucionet e Përkohshme në Veri | 12,2 % |
| Komunat e formuara pas zgjedhjeve 04/13..... | 10,8 % |
- 56% e qytetarëve mbështesin pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Serbisë në Kosovë
 - 45% e të anketuarve kanë pasur mundësi të marrin shërbime nga institucionet e Kosovës

³ Mozaiku i Kosovës 2015, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), UNDP dhe USAID.

Analiza gjinore shqyrton hierarkitë e pushtetit, ndarjen e punës, si dhe aspektet sociale dhe kulturore në institucione dhe komunitete, në mënyrë që të paraqesin mënyrën se si ndikojnë marrëdhëniet gjinore në vlerësimin bazë, zbatimin

• Çka mësojmë nga komunat veriore?

Në përmbledhje, ekzistojnë dallime gjinore të identifikuara sa i përket qasjes së grave dhe burrave në resurse, mobilitet, siguri, qasje në hapësira të gjelbra, të ardhurat dhe mundësi për punësim.

- Qasja në shërbimet e përgjegjshme publike, infrastrukturë adekuate dhe integrimi efikas

Edhe gratë edhe burrat hasin vështirësi në qasje në shërbime publike për shkak të sistemeve të dyfishta. Ata gjithashtu e shohin si të dobët transportin publik. Kjo ndikon keq në nivelin e mobilitetit të grave, pasi që ato kanë më pak qasje në vozitje dhe vetura, veçanërisht gratë rurale.

Sa i përket infrastrukturës, banorët e Zveçanit dhe Zubin Potokut përballen me furnizim të reduktuar me ujë dhe energji elektrike gjatë disa periudhave të vitit. Nuk ka rrjet të kanalizimit dhe ujërat e zeza shkarkohen direkt në lumenj. Një numër i madh i ekonomive familjare përdorin karburante fosile (thëngjill dhe dru) për ngrohje. Kjo mund të shkaktojë dëme serioze në shëndetin e familjeve, por gratë në veçanti janë më të ekspozuara ndaj kësaj.

Gratë dhe burrat shfrytëzojnë hapësirat e gjelbra për arsye të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Ekziston nevojë e konsiderueshme për përmirësime sa i përket qasjes në hapësira të gjelbra.

- Tregu i punës dhe sfera ekonomike

Gratë janë më të pranishme në ekonominë joformale. Edhe pse niveli i arsimit të grave është zakonisht më i lartë, prapë numri i grave të papuna është më i madh se i burrave; kjo qon në më pak mbrojtje nga sistemi, sa i përket qasjes në kujdesin shëndetësor dhe pensione, dhe i bënë ato ekonomikisht të varura.

• Fushat kryesore të diferencimit dhe prioriteteve

Si përfundim nga të gjeturat e paraqitura, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nivelit të qasshmërisë në kuadër

e programit dhe arritjet e pritura të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës. Analiza gjinore është kryer vetëm në katër komunat me shumicë serbe.

Në shumë raste, gratë janë rrallë si pronare të pronave dhe biznesit dhe mund të përjetojnë vështirësi në qasje në resurset financiare, p.sh., kredi, etj.

- Përgjegjësitë riprodhuese dhe ndarja e punës

Ndarja e punës në shtëpi është tradicionale dhe e pabarabartë. Gratë zakonisht kujdesen për fëmijë, bëjnë punë të shtëpisë dhe kujdesen për më të moshuarit, të sëmurët dhe personat me nevoja të veçanta në krahasim me burrat. Ndryshime të pakta janë vërejtur tek çiftet më të reja sa i përket përgjegjësisë për kujdes të fëmijëve.

Sa i përket martesës, është vërejtur se mënyrat po ndryshojnë për martesat e vonshme dhe mosha mesatare për t'u bërë prind është tani 25-27 vjeç për gratë dhe 28 për burrat. Kemi një shkallë më të lartë të migrimit të grave për shkak se ato zakonisht zhvendosen në shtëpinë e burrit me rastin e martesës.

- Qasja në asete dhe proceset vendimmarrëse për gratë, ekonominë familjare dhe komunitetin

Gratë janë të pak të përfaqësuara në politikë dhe nuk janë të angazhuara në punën në komunitet. Megjithatë, ato shqetësohen në lidhje me situatën aktuale politike dhe të ardhmen e komunitetit serb në Kosovë.

Gjithashtu gratë nuk kanë qasje në tokë dhe pronë për shkak të normave sociale tradicionale në lidhje me trashëgiminë pronësore dhe pronësinë që favorizojnë burrat.

Të gjitha komunat kanë kapacitete të ulëta gjinore institucionale.



INSTITUCIONET



MOBILITETI



TË ARDHURAT DHE
PUNËSIMI FORMAL



PRONËSIA E TOKËS
DHE BIZNESI



PUNA NË KOMUNITET
DHE POLITIKAT



RESURSET PRODUKTIVE
DHE JO-PRODUKTIVE



HAPËSIRAT PUBLIKE
DHE TË GJELBRA

• Orientimet kryesore për përmirësimin e barazisë gjinore në komunat veriore

Administratat lokale janë partnere kryesore që kanë nevojë për mbështetje në zhvillimin e qasjeve dhe shërbimeve të përgjegjshme gjinore dhe pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë, interesat strategjike gjinore mund të adresohen në orientimet strategjike kryesore në vijim.

KAPACITETI INSTITUCIONAL

Të zhvillohen kapacitetet gjinore institucionale dhe operacionale.

- Zhvilloni një kornizë strategjike dhe plan të veprimit për barazi gjinore. Për këtë duhet të ofrohen trajnime.
- Zhvilloni sisteme të përgjegjshme gjinore: mjetet për integrim gjinor që duhet të përdoren në procedurat dhe proceset e përditshme. Gjithashtu krijoni një rol të zyrtarit komunal për çështje gjinore dhe një pikë qendre e tij.
- Përmirësoni kapacitetet gjinore të vetëdijesimit, mirëkuptimit dhe ato operative të administratës lokale, duke përfshirë zyrtarët dhe stafin e administratës, nëpërmjet trajnimit të synuar. Ky trajnim duhet të shfrytëzohet edhe për fuqizimin e vetëdijesimit për mbledhjen e të dhënave të ndara.

TË DHËNAT

Të mblidhen të dhëna shtesë gjatë zbatimit të Programit.

- Mbështetni ngritjen e kapaciteteve të administratës lokale mbi ndarjen gjinore të të dhënave.
- Gjithashtu, nëse është e mundur, bëni aranzhime për mbledhjen e të dhënave shtesë mbi barazinë gjinore në mënyrë që të kemi një pamje më complete dhe të detajuar të përvojës, kushteve, perspektivave dhe pozitave të pushteteve ndërmjet grave dhe burrave.

PJESËMARRJA

Të sigurohet pjesëmarrja në vendimmarrje.

- Fuqizoni kapacitetin e komunave për aplikimin e metodologjive moderne pjesëmarrëse dhe të përgjegjshme gjinore për të përfshirë gratë dhe burrat në proceset konsultative.
- Fuqizoni vetëdijesimin e komunave për aplikimin e qasjes ndër sektoriale, duke marr parasysh ndryshimet tjera sociale.

PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Të fuqizohen kapacitetet të administratës lokale për integrim gjinor në planifikim hapësinor dhe zhvillim.

- Të mbështet administrata komunale në integrimin gjinor në planifikim hapësinor dhe punë të urbanizimit dhe të fuqizohet pjesëmarrja e grave dhe burrave në proceset e planifikimit hapësinor.

FUQIZIMI

Të merren parasysh kushtet e jetesës së grave dhe fuqizimi i grave.

- Kur dizajnoni aktivitetet, për t'ia dhënë grave mundësinë për pjesëmarrje, merrni parasysh këto në vijim: kushtet e jetesës dhe punës, mobilitetin e tyre të kufizuar në kontekstet rurale dhe efektet e dëmshme që dhuna në baza gjinore mund të ketë tek gratë dhe gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje.
- Keni parasysh dizajnimin e aktiviteteve që kanë për qëllim fuqizimin e grave dhe që janë të fokusuara vetëm tek gratë- gratë rurale në veçanti.

VETËDIJESIMI

Të ngritët vetëdijesimi i burrave.

- Dizajnoni aktivitetet e fokusuara tek burrat që kanë për qëllim vetëdijesimin e tyre në lidhje me barazinë gjinore.
- Identifikoni burrat që do të mund të vepronin si model dhe agjentë ndryshimi për të mbështetur barazinë gjinore në fusha të ndryshme të shoqërisë.

BASHKËPUNIMI

EKrijoni bashkëpunimin me agjentët relevant si OSHC-të, autoritetet kombëtare dhe agjencitë tjera ndërkombëtare. Për shembull, tashmë ekzistojnë disa iniciativa të OJQ-ve sa i përket fuqizimit të grave dhe vajzave (në Mitrovicën e jugut dhe Skenderaj).



PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS

UN HABITAT

Ministries Building "Rilindja"
10000 Prishtina, Kosovo
Tel.: +381 38 200 32611
info@unhabitat-kosovo.org

PAX

Sint Jacobsstraat 12
3511 BS Utrecht, The Netherlands
Tel.: +31 (0)30 233 33 46
info@paxforpeace.nl

CBM

Bulevardi Isa Boletini 11-12
40000 Mitrovica, Kosovo
Tel.: +381 28530335
info@cbmitrovica.org